



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.02.2021, ora 10:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Mirela Kumbaro – nënkryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 1 dhe 3 shkurt 2021.
2. Përzgjedhja e kandidatave për plotësimin e tri vendeve vakante për anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH-së, të cilat janë krijuar nga mbarimi i mandateve (*Vendimet nr. 6, 7 dhe 8 shkurt 2021*)(*Mbledhja vijon me dyer të mbyllura*).

#### **Marrin pjesë:**

Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Fatjona Dhimitri, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri, Amra Barova dhe Erion Piciri.

#### **Mungojnë:**

Ramazan Gjuzi, Enada Kapllani, Musa Uliqni.

#### **HAPET MBLEDHJA**

**Mirela Kumbaro** – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbaleve të datave 1 dhe 3 shkurt 2021.

Pika e dytë është përzgjedhja e kandidaturave për plotësimin e tri vendeve vakante për anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH-së, të cilat janë krijuar nga mbarimi i mandateve të zotit Vladimir Grosha, zotit Altin Shegani dhe zotit Robert Rakiplari.

Për të tria këto vende vakante ka kaluar procesi i shpalljes së kandidaturave. Ne kemi qenë prezentë në intervistimin e kandidatëve që u prezantuan.

Para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, më lejoni të bëjmë verifikimin e kuorunit.

Siç ju njoftova, zoti Gjuzi nuk është prezent.

Mirela Kumbaro, prezent; zoti Fidel Ylli, prezent; zoti Musa Ulqini njoftoi se do të hynte *online*, pasi kishte një problem me linjën; zonja Vilma Bello, prezent; zoti Ismet Beqiraj, prezent; zonja Adelina Rista, prezent; zoti Bujar Çela, prezent; zonja Almira Xhembulla, prezent; zonja Lindita Nikolla, prezent; zonja Enada Kapllani, nuk është prezent; zonja Fatjona Dhimitri, prezent; zoti Klajdi Qama, prezent; zoti Kostaq Papa, prezent; zoti Selami Jenishehri, prezent; zonja Amra Barova, prezent; zoti Erion Piciri, prezent.

Anëtarët e tjerë janë zëvendësues.

Kuorumi plotësohet dhe mund të vazhdojmë me mbledhjen.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të datave 1 dhe 3 shkurt 2021, të cilat i keni në *email*-et tuaja.

Kush është dakord me miratimin e procesverbaleve?

Miratohen procesverbalet.

Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës, te përzgjedhja e kandidaturave për plotësimin e tri vendeve vakante për anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH-së.

Para se të fillojmë me këtë pikë, më lejoni t'ju kujtoj se për këtë fazë, duke qenë se ka të bëjë me emra konkretë dhe me komente, edhe sipas traditës që kemi krijuar, kur anëtarët e komisionit duhet të votojnë për emra konkretë, që duhet të përzgjidhen pas një procesi intervistash, në respekt të integritetit, të privatësisë, por edhe të lirisë që duhet të kenë kolegët për t'u shprehur, këto mbledhje janë zhvilluar me dyer të mbyllura, kështu që e tillë do të bëhet edhe mbledhja e sotme. Kjo është një praktikë e mirë, ndaj besoj se do të duhet edhe në këtë rast.

Bazuar në nenin 35, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, propozoj që kjo pjesë e mbledhjes të zhvillohet me dyer të mbyllura.

Kush është dakord?

Miratohet.

Faleminderit!

*Mbledhja vijon me dyer të mbyllura*

**Sekretar  
Fidel Ylli**

**Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve  
Euzheni Pengili**

**Sekretare e komisionit  
Ariana Mero**